



Planuar / Dorëzuar Prijemjen/Prodato Received/Delivery	28.02.2022	2	viti god Year
Organ /Njësia Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM/SHCK	1018	2022	116



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1234/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Arben Mehmeti-anëtarë, dhe Avdyll Bektashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1234/2021 të datës 31.12.2021 të parashtruar nga ankuesi të cilin me autorizim e përfaqëson me adresë Prishtinë, kundër Vendimit me Nr.1425/2021 të datës 17.12.2021 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Punëve të Brendshme, në çështjen juridike "Largim nga shërbimi civil", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 28.02.2022, mori këtë:

V E N D I M

Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.1234/2021 e datës 31.12.2021 e parashtruar nga ankuesi Shfuqizohet Vendimi me numër protokoli 1425/2021 i datës 17.12.2021 i Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe lënda kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje të organi i njëjtë i cili e ka nxjerr aktin administrativ.

A r s y e t i m

Ankuesi, i punësuar në Ministrinë e Punëve të Brendshme, përmes përfaqësuesit të autorizuar, avokatit me datë 31.12.2021 ka parashtruar ankesë me numër protokoli 6445/2021 të regjistruar me numër A.nr.1234/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër protokoli 1425/2021 të datës 17.12.2021 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur

Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 18.01.2022 ka kërkuar përgjigje në ankesën e ankuesit nga Ministria e Punëve të Brendshme. Këshilli më datë 02.02.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke u bazuar në dispozitat e nenit 17 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 11.02.2022 ka nxjerr Vendimin me numër VK.nr.13/2022 përmes të cilit ka shtyrë afatin për vendosje edhe për 10 ditë pune lidhur me ankesën A.nr.1234/2021 të datës 31.12.2021.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 6445/2021 të regjistruar me numër A.nr.1234/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Akt Emërimin e datës 03.10.2016 për ankuesin; Ftesën për seancë disiplinore e datës 02.12.2021; Vendimin me Nr.1425/2021 të datës 17.12.2021 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Punëve të Brendshme; Procesverbali e Komisionit Disiplinor i datës 06.12.2021; Emailin e datës 17.12.2021 nga Law për Personelin e MPB; Emailin e datës 16.12.2021 nga Personeli i MPB për Law; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 18.01.2022; Përgjigjen në ankesë e datës 02.02.2022; Përshkrimin e detyrave të punës për Drejtor DSPIMNQ; Kërkesën për inicimin e procedurës disiplinore e datës 18.11.2021; Emailin e datës 19.11.2021 nga Personeli MPB për ankuesin; Vendimin e datës 19.11.2021 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Punëve të Brendshme; Procesverbalin e datës 19.11.2021 të Komisionit Disiplinor; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punës i datës 20.12.2019; Raporti i auditimit me kërkesë i datës 20.10.2021; Aktgjykimin e datës 02.02.2016 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike; Raportin e Komisionit të vlerësimit për ofertë e punës të parapara për kontratën me titull Lot 10 "Ndërtimi i Ndërtesës së IKAPI-t" i datës 06.10.2020; Letër e konfirmimit të datës 10.10.2019 Emailin e datës 28.10.2021 lidhur me raportin e auditimit DSPIMNQ; Njoftimin për përdorimin e procedurës së negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë i datës 13.07.2021; Ri-kërkesën për inicim të procedurave të prokurimit për punë shtesë për projektin Ndërtimi i ndërtesës së IKAP-it e datës 16.07.2021; Ri-kërkesë për inicim të procedurave të prokurimit për punë shtesë dhe të pa parapara të projektit "Impianti për trajtimin e ujërave të zeza ITUZ në bllokun e urban Prishtina e Re datë 21.07.2021; Raporti i Auditimit të Performancës Menaxhimi i Kontratave publike të ndërtimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit tetor 2019; Shkresë me titull Planifikimi Përfundimtar i Prokurimit i datës 21.09.2021; Kërkesë për inicimin e prokurimit e datës 16.08.2021; Kërkesë për përzgjedhjen e OR për Mirëmbajtjen Higjienike të Kompleksit Rilindja e datës 16.08.2021; Emailin e datës e datës 22.09.2021 ; Emailin e datës 22.09.2021 nga Kërkesën për përshpejtimin e procedurave për Mirëmbajtjen Higjienike të kompleksit Rilindja e datës 15.09.2021; Emailin e datës 07.10.2021, 21.10.2021 dhe 27.10.2021 nga Emailin e datës 24.09.2021 nga Emailin e datës 21.10.2021 nga Emailin e datës 27.10.2021, 21.10.2021 nga për ankuesin; Emailin e datës 03.12.2021 nga për Emailin e datës 11.11.2021 nga Emailin e datës 16.11.2021, 15.11.2021 nga Emailin e datës 15.11.2021 nga ankuesi; Emailin e datës 15.11.2021 nga për Emailin e datës 16.11.2021 nga ankuesi për Emailin e datës 16.11.2021 nga për ankuesin; Emailin e datës 17.11.2021 nga ankuesi për Emailin e datës 16.11.2021 nga për ankuesin; Emailin e datës 23.08.2021, 04.10.2021 nga Emailin e datës 07.10.2021,

15.10.2021, 28.10.2021, 09.11.2021 nga J.Kastrati; Emailin e datës 15.10.2021 nga Emailin e datës 15.10.2021 nga ankuesi për Emailin e datës 09.11.2021, 20.10.2021 nga për ankuesin; Emailin e datës 20.10.2020, 07.10.2021 nga Emailin e datës 07.10.2021 nga Emailin e datës 07.10.2021 nga Emailin e datës 09.11.2021 nga Emailin e datës 09.11.2021 nga Vendimin VK.nr.13/2022 i datës 11.02.2021 për shtyrje të afatit për vendosje.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët, konstatoi se janë përmbushur kushtet ligjore që lënda të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje të organi i njëjtë, *sepse*:

Bazuar në shkresat e lëndës gjegjësisht Akt Emërimit me numër protokolli 90/2016 të datës 03.10.2016 rezulton se ankuesi është i punësuar në pozitën e punës *Drejtor i Departamentit të Standardëve të Politikave të Inxhinieringut dhe Menaxhimit të Ndërtesave Qeveritare (DSPIMNQ)*, në ministrinë përgjegjëse për administratë publike, respektivisht Ministrinë e Punëve të Brendshme të Republikës së Kosovës.

Zëvendësuesja e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme, me datë 18.11.2021 përmes shkresës me numër protokolli 1253 ka iniciuar procedurën disiplinore ndaj ankuesit nën dyshimin për mos përmbushje të detyrave të punës, mosrespektim i afateve të caktuar në përmbushjen e detyrave, të cilat kanë sjell pasoja të rënda, moszbatim i dispozitave ligjore për përmbushjen e detyrave funksionale si dhe shkelej e detyrimeve të përcaktuara me legjislacionin në fuqi në kuptim të nenit 46 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1, 3.2, 3.3 dhe 3.10 të Ligji Nr.06/L-114 për Zyrarët Publikë. Me tutje iniciuesi i procedurës i propozon Komisionit Disiplinor që pas trajtimit të rastit, ankuesit t'i shqiptohet mase disiplinore "*Largim nga Shërbimi Civil*", në kuptim të nenit 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të Ligji Nr.06/L-114 për Zyrarët Publikë.

Komisioni Disiplinor pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme, me datë 19.11.2021 ka nxjerr Vendimin me numër protokolli 1259/2021 me të cilin ankuesin e ka pezulluar nga detyra, ndërsa me datë 17.12.2021, organi i njëjtë, ka nxjerr Vendimin me numër protokolli 1425/2021 përmes të cilit ka konstatuar se ankuesi ka bërë shkelje të rëndë disiplinore nga neni 46 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1, 3.2, 3.3 dhe 3.10 të Ligji Nr.06/L-114 për Zyrarët Publikë, për shkak të: Parregullsive në procedurat e prokurimit të iniciuara nga *DSPIMNQ* për mirëmbajtje higjienike; Mos përmbushjes së detyrave funksionale-humbje e kontesteve gjyqësore; Shkeljes së detyrimeve të përcaktuara me legjislacionin në fuqi me rastin e emërimit të komisioneve të vlerësimit dhe negocimit të punëve shtesë pa marr aprovim nga Zyrtari Kryesor Administrativ; Parregullsive me rastin e lidhjes së aneks kontratave sipas të gjeturave të Raportit të Zyrës Kombëtare të Auditimit, tetor 2019; Neglizhencës në trajtimin e kërkesave të eprorit/mbikëqyrësit të drejtpërdrejtët si dhe ato të institucioneve tjera që bijën në fushëveprimin e *DSPIMNQ*, dhe rrjedhimisht duke u bazuar në nenin 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të Ligji Nr.06/L-114 për Zyrarët Publikë, ankuesit i ka shqiptuar masën disiplinore "*Largim nga Shërbimi Civil*".

Kundër Vendimit me numër protokolli 1425/2021 të datës 17.12.2021 të Komisionit Disiplinor, ankuesi brenda afatit ligjor, me datë 31.12.2021 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor se vendimi për shqiptimin e

masës disiplinore *Largim nga shërbimi civil* është nxjerr përmes shkeljeve procedurale dhe materiale, sepse në seancën dëgjimore të komisionit disiplinor nuk është ftuar edhe iniciuesi i procedurës disiplinore me qëllim të ballafaqimit të fakteve; Ankuesit nuk i është dhënë qasje në dosje, respektivisht në sigurimin e provave në e-mail dhe në arkivin e ministrisë; Nuk janë shqyrtuar drejtë faktet dhe provat e lëndës dhe nuk janë konstatuar në mënyrë të drejtë elementet e shkeljes disiplinore si dhe fajësia e ankuesit.

Lidhur me shqyrtimin e ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankuesit Kolegji analizoi shkresat e lëndës dhe rrjedhimisht duke ju referuar Vendimit me numër protokollit 1425/2021 të datës 17.12.2021 të Komisionit Disiplinor dhe Procesverbalit të datës 06.12.2021, konstatoi se seanca dëgjimore lidhur me vërtetimin e shkeljeve disiplinore të ankuesit është mbajtur me datë 06.12.2021, në prani të palës ankuese dhe përfaqësuesit të tij të autorizuar, ndërsa sipas provave të dorëzuara nga organi i punësimit nuk ka dëshmi që vërteton se Komisioni Disiplinor në seancë dëgjimore ka ftuar edhe iniciuesin e procedurës disiplinore, në rastin konkret Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Me dispozitat e Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenin 49 paragrafi 1 përcaktohet se: 1. *Në çdo institucion, në fushën e veprimit të këtij ligji, themelohet një komision disiplinor me mandat 3 vjeçar, që përfshin së paku një përfaqësues të njësisë përgjegjëse*, ndërsa me paragrafin 6 të këtij neni përcaktohet se: 6. *Qeveria, me propozimin e ministrisë përgjegjëse për administratën publike, me akt nënligjor, miraton rregullat e hollësishme për themelimin, përbërjen, përzgjedhjen dhe vendimmarrjen në komisionin disiplinor dhe në Këshillin Shtetëror për Vlerësim dhe Disiplinë, në përputhje me rregullat e përgjithshme të përcaktuara në Ligjin për Procedurat e Përgjithshme Administrative*. Rrjedhimisht, Qeveria e Republikës së Kosovës me datë 21.08.2020 ka aprovuar Rregulloren (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, akt ky i cili ka hyre në fuqi me datë 27.08.2020, dhe ka përcaktuar, procedurat dhe masat disiplinore për nëpunësit civil, themelimin, përbërjen dhe përzgjedhjen e anëtarëve të komisionit disiplinor, si dhe ankesat e nëpunësve civil me rastin e shqiptimit të masave disiplinore, në pajtim me Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë. Me dispozitat e nenin 11 të kësaj rregullore përcaktohet se: *Komisioni disiplinor ka këto kompetenca: 1.1. Bënë shqyrtimin e fakteve dhe provave të paraqitura; 1.2. Përcakton dhe shqipton masën disiplinore*. Ndërsa me nenin 12 paragrafi 3 nën paragrafin 3.3 të kësaj rregullore përcaktohet se: 3. *Komisioni disiplinor kryen edhe këto veprime deri në marrjen e vendimit: 3.3. Fton iniciuesin dhe nëpunësin civil ndaj të cilit është iniciuar procedura disiplinore për t'u njohur me variantin e tyre të ngjarjes apo të problemit*. Andaj, në kuptim të këtyre dispozitave ligjore, dhe me qëllim të vërtetimit të drejtë të gjendjes faktike, Kolegji vlerëson se Komisioni Disiplinor gjatë zhvillimit të procedurës disiplinore duhet të ftoj në seancë dëgjimore përveç nëpunësin civil që supozohet se ka bërë shkelje edhe iniciuesin e procedurës disiplinore, për tu njohur me variantin e tij të problemit sepse iniciuesi i procedurës disiplinore në fazat e mëvonshme të procedurës nuk mundet të godas me mjete ankimore vendimin përfundimtar të Komisionit Disiplinor.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, duke u bazuar në procesverbalin e seancës dëgjimore të datës 06.12.2021, të Komisionit Disiplinor, po ashtu ka gjetur se përfaqësuesi i autorizuar i ankuesit ka kërkuar që t'i lejohet qasja ankuesit në dokumentet zyrtare dhe rrjedhimisht arkivin e ministrisë me qëllim të sigurimit të provave shfaqësuese, ndërsa organi i punësimit në kuadër të shkresave të lëndës nuk ka sjellë asnjë dëshmi që vërteton se ankuesit i

është lejuar qasja në rrugë zyrtare në shkresat për të cilat ankuesi i konsideron të rëndësishme për mbrojtje në procedurë disiplinore.

Me dispozitat e Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenin 48 paragrafi 6 përcaktohet se: *Procedura administrative disiplinore garanton të drejtën e nëpunësit për t'u njoftuar lidhur me fillimin e procedimit, për t'u informuar lidhur me shkeljen faktike të pretenduar dhe provat për kryerjen e saj, të drejtën për t'u dëgjuar, për të paraqitur prova, të drejtën për të pasur qasje në dokumente që lidhen me procedurën, për mbrojtje juridike dhe të drejtën për t'u asistuar, si dhe të drejtën për t'u ankuar ndaj vendimit përfundimtar. Nëpunësi civil mund të ndihmohet gjatë procedurave disiplinore nga një përfaqësues i sindikatës ku bën pjesë, nga një avokat apo nga një përfaqësues i nëpunësve civilë të institucionit, nëse nuk është anëtar i një sindikate.* E drejta e palës që të njihet me dokumentet e dosjes së procedurës është e garantuar edhe me dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht neni 9 paragrafi 2 ku përcaktohet se: 2. *Organi publik duhet të garantojë të drejtën e palës për t'u informuar mbi ecurinë e procedurës administrative, qasjen në dosjen dhe dokumentet e tij dhe të drejtën e njoftimit me mjete të përshtatshme, në pajtim me këtë Ligj, dhe nenin 92 paragrafi 1 ku përcaktohet se: 1. Pala, në çdo fazë të procedurës, ka të drejtë të njihet me dokumentet e dosjes së procedurës administrative dhe të marrë kopje të dokumenteve që gjenden në të. Kolegji, bazuar në këto dispozita ligjore konstaton se nëpunësit civil ndaj të cilit është duke u zhvilluar procedura disiplinore i garantohet e drejta për të pasur qasje në dokumentet që lidhen me procedurën, dhe se organi i punësimit nuk mund të ia mohoi këtë të drejtë nëpunësit civil sepse duke ia mohuar një të drejtë të tillë, nëpunësit civil i pamundësohet sigurimi dhe paraqitja e provave shfaqësuese para Komisionit Disiplinor.*

Andaj, duke marr parasysh se ankuesi përmes Vendimit me numër protokolli 1259 është pezulluar nga marrëdhënia e punës me datë 19.11.2021, në ditën kur edhe është njoftuar përmes e-mailit zyrtar për inicim të procedurës disiplinore, dhe meqenëse në shkresa të lëndës nuk ka ndonjë dëshmi që vërteton se ankuesit i është lejuar qasja në dokumentet që lidhen me procedurën disiplinore, edhe përkundër kërkesës se parashtruar nga përfaqësuesi i autorizuar i ankuesit gjatë seancës dëgjimore, Kolegji konstaton se Komisioni Disiplinor me rastin e mohimit të drejtës së ankuesit për qasje në dokumente që lidhen me procedurën dhe njeherit mos ofrimin e një arsytimi të bazuar në ligj, ka vepruar në kundërshtim me parimin e ligjshmërisë të përcaktuar me nenin 4 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.


Mbi bazën e të lartcekurave Kolegji gjeti se Vendimi me numër protokolli 1425/2021 i datës 17.12.2021 është nxjerr përmes shkeljeve procedurale të cekura si me lartë për çka edhe i njëjti u deshtë të shfuqizohet dhe lënda të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje në Komision Disiplinor ngase Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave nuk ka pasur kushte që të vendos në mënyrë meritore për çështjen në fjalë. Në ri procedurë Komisioni Disiplinor pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme duhet të ketë parasysh vërejtjet e dhëna si me lartë dhe t'i eliminoj të njëjtat.

Nga të cekurat me lartë e në mbështetje të dispozitave të nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.


KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1234/2021

Avdyl BEKTESHI


Procesmbajtës



Jeton KOCA


Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet

- Përfaqësuesit të aneksit Avokat
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme;
- Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Punëve të Brendshme;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

